



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 160

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 18 shtator 2024

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 11.9.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pronave të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale 1739, Bashkia Himarë, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik <i>‘White Roads Hotel’</i> ”.....	19163
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 481, datë 10.9.2024	Mbi procedurat e verifikimit dhe shqyrtimin e kërkesës së mjekëve të institucioneve publike për të ushtruar profesionin në institucione jopublike, publikimin e të dhënave në regjistrin elektronik, formatin dhe mënyrën e përditësimit të regjistrit.....	19180
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 437, datë 12.9.2024	Për delegim kompetence.....	19183
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 677, datë 6.9.2024	Për miratimin e kontratës tip për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe subjektit fitues të procedurës së konkurrimit publik.....	19183
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 693, datë 12.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	19189
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 694, datë 12.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Bullgarisë.....	19190
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 695, datë 12.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë.....	19191
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 696, datë 12.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	19194

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 697, datë 12.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Çekisë.....	19197
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 698, datë 12.9.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Francës.....	19198
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13517, datë 13.9.2024	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje me Bashkimin Evropian.....	19199
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 26, datë 12.9.2024	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Shkodër sh.a.....	19199
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 27, datë 12.9.2024	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a.....	19201
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 598 (3265), datë 9.7.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Asim Malaj.....	19202
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 572 (3121), datë 2.7.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Sokol Gradeci.....	19202



VENDIM

Nr. 560, datë 11.9.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 545, DATË 29.7.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
TRANSFERIMIN NË FONDIN E
PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR
MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE
STRATEGJIKE DHE KALIMIN NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË FINANCave DHE
EKONOMISË TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË
ZONËN KADASTRALE 1739, BASHKIA
HIMARË, PËR ZHVILLIMIN DHE
REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES
STRATEGJIK ‘WHITE ROADS HOTEL’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 545, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull, fjalët “... në zonën kadastrale 1739 ...” zëvendësohen me “... në zonat kadastrale 1739 dhe 2863 ...”.

2. Në titull dhe në pikën 1, emërtesa “... Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ...” zëvendësohet me “... Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ...”.

3. Në fund të pikës 1 shtohen fjalët “... si dhe të disa pronave të llojit “kullotë”, me sipërfaqe totale 21 979.4 (njëzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë katër) m², në të njëjtën vendndodhje, në zonën kadastrale nr. 1739, me numra pasurie 68/49, 68/50, 68/51/3, 68/119/1, dhe në zonën kadastrale nr. 2863, me numër pasurie 30/158, sipas aneksit 1/1 dhe dokumentacionit të pronësisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.

4. Në pikën 3, pas fjalëve “... në vendimin nr. 1/6, datë 5.4.2022, ...” shtohen “... dhe në vendimin nr. 34/11, datë 1.8.2023, ...”, ndërsa fjalët “... ministrit të Financave dhe Ekonomisë ...” zëvendësohen me “... ministrit përgjegjës për ekonominë ...”.

5. Pas aneksit 1, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



KOORDINATAT				
PIKA	E	N	PIKA	N
1	380681.452	4447666.006	31	380535.248
2	380692.607	4447651.689	32	380525.286
3	380566.360	4447575.367	33	380501.360
4	380499.063	4447523.422	34	380502.206
5	380512.576	4447503.778	35	380508.033
6	380541.916	4447475.174	36	380390.744
7	380569.980	4447495.003	37	380425.980
8	380581.040	4447515.345	38	380374.231
9	380740.774	4447538.104	39	380359.176
10	380478.229	4447506.103	40	380339.839
11	380443.629	4447421.548	41	380285.543
12	380495.440	4447398.793	42	380272.181
13	380394.208	4447292.937	43	380265.622
14	380408.335	4447330.245	44	380273.627
15	380432.101	4447361.772	45	380295.186
16	380472.916	4447385.402	46	380313.258
17	380521.686	4447415.090	47	380349.129
18	380498.507	4447430.965	48	380250.575
19	380471.643	4447391.177	49	380241.574
20	380451.778	4447404.145	50	380177.412
21	380476.699	4447442.321	51	380222.171
22	380403.789	4447430.820	52	380225.062
23	380496.635	4447435.618	53	380228.011
24	380503.278	4447449.353	54	380235.662
25	380519.158	4447487.527	55	380245.140
26	380505.603	4447507.697	56	380251.010
27	380524.004	4447487.547	57	380260.023
28	380538.548	4447473.523	58	380252.414
29	380566.560	4447484.849	59	380252.131
30	380556.312	4447452.781	60	380254.885

LEGJENDA

- Statusi i fituar Vendim i KIS, Nr 1/6, datë 05.04.2022
- Aplikim shitesë: Zona Veri-Lindje
- SUPERFAQE: **21979.40 m2**

Monument: Delta e Perroit te Palases


Emërtimi: Piketimi i koordinatave mbi Rilevimin Topografik faktik.
Zona shitesë: Zona Veri-Lindje

Shkalla 1:2500 Formati: A3

PUNOI: ING. BLERIM LAMAJ
LIC. NR. T1180/1

ANEKSI NR. 1/1

GENPLAN





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1739002002
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1739, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 68/49, Sipërfaqja Totale 5139.8 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale k-34-136 (115D), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia HIMARE, Rruga GJILEK, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET - SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT SG8688151065, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANË, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Regjistruar: Nr. LN2017, Datë: 01/05/2017

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____
Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: VENDIM I KOMITETIT TE INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR 34/11 DATE 01.08.2023 DHE VKM NR 187 DATE 25.03.2021

DREJTORI

Ina Luçaj



Erion
Rrushi

Digitally signed by:
Erion Rrushi
Date: 2024.06.24
03:15:24 +02'00'

Ina
Luçaj

Digitally signed by:
Ina Luçaj
Date: 2024.06.25
05:01:46 +02'00'

Data e lëshimit 24/06/2024

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlore
Shënim : Ky dokument është gjeneruar nga një procedurë automatike nga një sistem informatic (Kadastër)
Date: 2024.06.24 15:15:03 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1739

KODI UNIK: 1739002002

NUMRI PASURISË : 68/49

INDEX I HARTËS: K-34-136-(115-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Arrian

Digitally signed by:
Arrian Todi

Date: 2024.06.25

10:55:59 +02'00'

Todi
Data e lëshimit 24 / 06 / 2024Digitally signed by:
Erion Rrushi

Date: 2024.06.25

11:03:22 +02'00'

Rrushi

Ina

Digitally signed by:
Ina Lucaj

Date: 2024.06.25

05:01:16 +02'00'

Lucaj

DREJTORI
(Emer Mbiemer)Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2024/06/25 10:55:27 +02'00'
M02407023J2024062510552039014Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)

SHPJEGUES

PARCELA
NDERTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1739002003
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1739, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 68/50, Sipërfaqja Totale 2482.6 m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale k-34-136 (115D), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia HIMARË, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET - SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT SG8688151065, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANË, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. LN2017, Datë: 01/05/2017

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektivit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera, Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 34/11,
Datë: 01/08/2023

Regjistruar: Nr. 002636, Datë: 08/02/2024

Përshkrimi: VENDIM I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE nr.34/11 date: 01.08.2023
DHE VKM NR. 187 dt:25.03.2021

DREJTORI

Ina Luçaj



Erion
Rrushi

Digitally signed by:
Erion Rrushi
Date: 2024.06.24
03:16:05 +02'00'

Ardian
Todhri

Digitally signed by:
Ardian Todhri
Date: 2024.06.25
10:57:46 +02'00'

Data e lëshimit

Ina
Luçaj

24/06/2024

Digitally signed by:
Ina Luçaj
Date: 2024.06.25
05:02:42 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria

Vendore Vlore

Shënim: Ky dokument është gjeneruar automatikisht nga një sistem informatic dhe ka vlerë ligjore.
Data: 2024.06.24 15:15:52 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1739

KODI UNIK: 1739002003

NUMRI PASURISË : 68/50

INDEX I HARTËS: K-34-136-(115-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

DREJTORI
(Emer Mbiemer)Digitally signed by: Ardian Todhri
Date: 2024.06.25
10:57:20 +02'00'

Data e lëshimit 24 / 06 / 2024

Digitally signed by: Erion Rrushi
Date: 2024.06.25
11:03:48 +02'00'Digitally signed by: Ina Lucaj
Date: 2024.06.25
05:02:19 +02'00'Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2024/06/25 10:56:51 +02'00'
M02407023J2024062510564472014Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)

SHPJEGUES

PARCELA
NDERTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1739008081

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1739, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 68/51/3, Sipërfaqja Totale 6584 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-136-(115-D), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia HIMARE, Rruga GJILEK, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 00002583, Dt. 26/12/2023), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, Nr. Identifikimi/NIPT R00000000SH, Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. 00002583, Datë: 26/12/2023

Regjistruar: Nr. 00002583, Datë: 18/12/2023

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera, Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 34/11,
Datë: 01/08/2023

Regjistruar: Nr. 002630, Datë: 07/02/2024

Përshkrimi: VENDIM I KOMITETIT TE INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR 34/11 DATE 01.08.2023 DHE V.K.M.-se NR 187 DATE 25.03.2021

DREJTORI

Ina Luçaj



Erion
Rrushi

Digitally signed by:
Erion Rrushi
Date: 2024.06.24
03:17:25 +02'00'

Ardian
Todhri

Data e lëshimit

Digitally signed by:
Ardian Todhri
Date: 2024.06.25
10:59:28 +02'00'

Ina
Luçaj

24/06/2024

Digitally signed by:
Ina Luçaj
Date: 2024.06.25
05:08:44 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria

Shënim: Ky dokument është gjeneruar automatikisht nga një sistem informatic dhe nuk ka vlerë juridike.
Data: 2024/06/24 15:17:11 +02'00'
MO24070233024062415170431ASHK

2/2

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1739

KODI UNIK: 1739008081

NUMRI PASURISË : 68/51/3

INDEX I HARTËS: K-34-136-(115-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

DREJTORI
(Emer Mbiemer)Ardian
Todhri
Data e lëshimit 24 / 06 / 2024Digitally signed by:
Ardian Todhri
Date: 2024.06.25
10:58:58 +02'00'Digitally signed by:
Erion Rrushi
Date: 2024.06.25
11:04:14 +02'00'Digitally signed by:
Ina Lucaj
Date: 2024.06.25
05:03:39 +02'00'Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2024/06/25 10:58:38 +02'00'
M02407023J2024062510583128014Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDERTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1739008083

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 1739, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 68/119/1, Sipërfaqja Totale 3273 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-136-(115-D), Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia HIMARE, Rruga GJILEK, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 199, Dt. 04/01/2024), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia Shtet, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Regjistrim i bashkimit, ose ndarjes të pasurisë së paluajtshme, Nr. 199, Datë: 04/01/2024

Regjistruar: Nr. 00002589, Datë: 09/01/2024

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera, Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 34/11,
Datë: 01/08/2023

Regjistruar: Nr. 2627, Datë: 07/02/2024

Përshkrimi: PER KETE PASURI ESHTË DHENE VENDIM I KOMITETIT TE INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR. 34/11 DATE 01.08.2023 DHE V.K.M NR. 187 DATE 25.03.2021
VJEN NGA PASURIA 68/119 VOLUM 2 FAQE 5

DREJTORI

Ina Luçaj



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria

Vendore Vlorë

Shënim: Ky dokument është sjeneruar automatikisht nga një procedurë automatike nga një sistem informatic (Kadastri)

Erion

Rrushi

Digitally signed by:

Erion Rrushi

Date: 2024.06.24

03:17:55 +02'00'

Ardian

Todhri

Data e lëshimit

Digitally signed by:

Ardian Todhri

Date: 2024.06.25

11:00:48 +02'00'

Erion

Rrushi

24/06/2024

Digitally signed by:

Erion Rrushi

Date: 2024.06.25

11:04:37 +02'00'

Ina

Luçaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1739

KODI UNIK: 1739008083

NUMRI PASURISË : 68/119/1

INDEX I HARTËS: K-34-136-(115-D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Ardian

Digitally signed by:
Ardian Todhri
Date: 2024.06.25
11:00:30 +02'00'Digitally signed by:
Erion Rrushi
Date: 2024.06.25
11:04:55 +02'00'Digitally signed by:
Ina Lucaj
Date: 2024.06.25
05:06:13 +02'00'DREJTORI
(Emer Mbiemer)

Data e lëshimit 24 / 06 / 2024

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2024/06/25 10:59:52 +02'00'
M02407023J2024062510594575014Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)SHPJEGUES
PARCELA
NDERTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 2863006061
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 2863, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 30/158, Sipërfaqja Totale 4500 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale K34-136-(116-C), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia HIMARE, Rruga PALASE, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 34/11, Dt. 01/08/2023, Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____))

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET - -, Nr. Identifikimi/NIPT SG7639160145, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 34/11, Datë: 01/08/2023

Regjistruar: Nr. 00000353, Datë: 22/11/2023

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera, Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 34/11,
Datë: 01/08/2023

Regjistruar: Nr. 00000353, Datë: 22/11/2023

Përshkrimi: VENDIM I KOMITETIT TE INVESTIMEVE STRATEGJIKE NR 34/11 DATE
01.08.2023 DHE VKM NR 187 DATE 25.03.2021
VIJON NGA VOLUM 4 FAQE 59

DREJTORI
Ina Luçaj



Erion
Rrushi

Digitally signed by:
Erion Rrushi
Date: 2024.06.24
03:16:50 +02'00'

Ardian
Todhri

Digitally signed by:
Ardian Todhri
Date: 2024.06.25
10:58:11 +02'00'

Data e lëshimit: **24/06/2024**
Digitally signed by:
Ina Luçaj
Date: 2024.06.25
05:03:11 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria

Vendore Vlore

Shënim: Ky dokument është gjeneruar nga një procedurë automatike nga një sistem informatic i Agjencisë së Kadastrës.
M0240702302024062415163340ASHK

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 2863

KODI UNIK: 2863006061

NUMRI PASURISË : 30/158

INDEX I HARTËS: K-34-136-(116-C)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

DREJTORI
(Emer Mbiemer)Ardian Todhri
Data e lëshimit 06 / 07 / 2024Digitally signed by:
Ardian Todhri
Date: 2024.07.06
10:11:23 +02'00'Digitally signed by:
Valon SH 12500
Date: 2024.07.08
09:14:21 +02'00'Digitally signed by:
Valentina Lekaj
Date: 2024.07.08
09:33:37 +02'00'Digitally signed by:
Ina Lucaj
Date: 2024.07.08
09:33:37 +02'00'Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2024/07/06 10:11:12 +02'00'
M02407023J2024070610110552014Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDERTESA



UDHËZIM

Nr. 481, datë 10.9.2024

**MBI PROCEDURAT E VERIFIKIMIT
DHE SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
MJEKËVE TË INSTITUCIONEVE
PUBLIKE PËR TË USHTRUAR
PROFESIONIN NË INSTITUCIONE
JOPUBLIKE, PUBLIKIMIN E TË
DHËNAVE NË REGJISTRIN
ELEKTRONIK, FORMATIN DHE
MËNYRËN E PËRDITËSIMIT
TË REGJISTRIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8/a, pika 9, të ligjit nr. 123/2014, “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. PUNËSIMI I MJEKËVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE PRANË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE JOPUBLIKE

1. Mjekët e punësuar në institucionet shëndetësore publike, të cilët dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e tyre edhe në institucione shëndetësore jopublike, duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim pranë titullarit të institucionit shëndetësor publik ku ushtrojnë profesionin e tyre.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, titullari i institucionit shëndetësor publik konsiderohet funksionari më i lartë në atë institucion. Në rast se vetë titullari kërkon që të paraqesë kërkesë për të ushtruar profesionin në institucione shëndetësore jopublike, ajo i paraqitet për vlerësim dhe miratim sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, i cili ndjek të njëjtën procedurë vlerësimi, të përshkruar në këtë udhëzim.

3. Mjeku që kërkon të ushtrojë profesionin e tij edhe pranë një institucioni shëndetësor jopublik, në kërkesën e paraqitur duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) specialitetin (nëse ka);

c) nëse është ose jo anëtar i personelit akademik në një institucion të arsimit të lartë (IAL) publik ose jopublik, duke dhënë edhe ngarkesën përkatëse, nëse ushton këtë funksion;

ç) institucionin shëndetësor jopublik ku dëshiron të ushtrojë profesionin;

d) statusin e tij në institucionin shëndetësor jopublik (nëse është ortak/aksionar, administrator, i punësuar apo tregtar);

e) specialitetin që kërkon të ushtrojë;

f) kohëzgjatjen e kësaj marrëdhënieje (me afat ose pa afat);

g) koha dhe orari gjatë së cilës mjeku ushtron profesionin në institucionin shëndetësor jopublik.

4. Nëse kërkesa nuk përmban të gjitha elementet e nevojshme, titullari i institucionit i jep mjekut një afat 5-ditor për plotësimin e të metave. Nëse të metat nuk plotësohen brenda këtij afati, titullari vendos mosshqyrtimin e kërkesës.

5. Titullari i institucionit shëndetësor publik, gjatë vlerësimit për miratimin ose jo të kërkesës së mjekut, merr në konsideratë:

a) ngarkesën e orëve që mjeku ushtron në institucionin shëndetësor publik;

b) ngarkesën mendore dhe fizike që kërkohet për llojin e specialitetit që mjeku ushtron në institucionin shëndetësor publik dhe atë që kërkon të ushtrojë në institucionin shëndetësor jopublik. Për vlerësimin e këtij aspekti, titullari i referohet të dhënave shkencore të publikuara, që kanë të bëjnë me specialitete të ndryshme mjekësore, vendase dhe të huaja;

c) korrektësinë e mjekut në respektimin e orarit të punës, para paraqitjes së kërkesës;

d) mbulimin e shërbimit nga personeli tjetër mjekësor në institucionin shëndetësor publik;

e) krahasimin e orëve mujore të punës që ushtron në institucionin shëndetësor publik, me orët e punës që propozon të ushtrojë në institucionin shëndetësor jopublik;

f) mundësinë e konfliktit të interesit;

g) nëse ka apo jo një pozicion drejtues në një institucion shëndetësor publik apo në Universitetin Mjekësor.

6. Bazuar në kriteret e sipërpërmendura, titullari i institucionit shëndetësor publik, brenda 10 ditëve, duhet të vendosë, në mënyrë të arsyetuar:

- a) mosmiratimin e kërkesës;
- b) miratimin e kërkesës.

7. Në rast miratimi të kërkesës, titullari i institucionit njofton ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, duke i bashkëlidhur kërkesën e mjekut, vendimin e arsyetuar, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme për publikim në regjistrin përkatës.



8. Titullari i institucionit shëndetësor publik vendos mosmiratimin e kërkesës së mjekut, nëse nuk plotësohen kriteret e përmendura në këtë udhëzim.

9. Kundër vendimit për mosshqyrtimin e kërkesës, sipas pikës 4, ose mosmiratimin e kërkesës, sipas pikës 6 të këtij udhëzimi, mjeku ka të drejtë të ankohet brenda 30 ditëve pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, duke respektuar kërkesat e neneve 130–135 të Kodit të Procedurave Administrative.

10. Nëse titullari i institucionit shëndetësor publik nuk shprehet brenda 10 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, mjeku ka të drejtë të ankohet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, brenda 7 ditëve nga përfundimi i këtij afati.

11. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, në përputhje me nenin 43 të Kodit të Procedurave Administrative, cakton një njësi përgjegjëse për vlerësimin e ankimit të paraqitur.

12. Njësia përgjegjëse shqyrton ankimin, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, brenda një afati 10-ditor, dhe vendos për detyrimin e titullarit të shprehet, nëse është vendosur mosshqyrtimi i kërkesës.

13. Në raste të tjera, njësia përgjegjëse, mbasi shqyrton ankimin, brenda afatit 30-ditor, i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë:

a) miratimin e vendimit të titullarit të institucionit shëndetësor publik;

b) ndryshimin e vendimit të titullarit të institucionit shëndetësor publik dhe miratimin e kërkesës.

14. Ankimi i paraqitur sipas pikës 10 të këtij udhëzimi shqyrtohet nga njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve, e cila vendos t'i kërkojë titullarit të institucionit publik që të mbajë qëndrim brenda 5 ditëve.

II. REGJISTRI PUBLIK ELEKTRONIK

15. Regjistri Publik Elektronik përmban këto të dhëna për mjekun:

a) emri;

b) mbiemri;

c) institucioni shëndetësor publik ku ushtron profesionin;

d) specialiteti (nëse ka);

e) nëse është e zbatueshme, të dhëna lidhur me punësimin e tij si personel akademik pranë Universitetit Mjekësor;

f) institucioni shëndetësor jopublik, për të cilin është pranuar kërkesa për ushtrimin e profesionit;

g) statusi i mjekut në institucionin shëndetësor jopublik (ortak/aksionar, administrator, i punësuar, apo tregtar);

h) specialiteti që ushtron në institucionin shëndetësor jopublik;

i) koha dhe orari gjatë së cilës mjeku ushtron profesionin në institucionin shëndetësor jopublik.

III. NDRYSHIMI I TË DHËNAVE

16. Në çdo rast që ka ndryshime në të dhënat në kërkesën e paraqitur ose të dhënat që publikohen në Regjistrin Publik Elektronik, mjeku njofton titullarin e institucionit shëndetësor publik, i cili ndjek, me ndryshimet përkatëse, parashikimet e pikave 3–5 të këtij udhëzimi, për vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës.

17. Në rast mosmiratimi të këtyre ndryshimeve ose mosshprehjes nga ana e titullarit, mjeku ka të drejtë të ankohet sipas parashikimeve të pikave 9–14 të këtij udhëzimi.

IV. DISPOZITA TRANZITORE

18. Mjekët, që me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi ushtrojnë profesionin e tyre njëkohësisht në një institucion shëndetësor publik dhe në një institucion shëndetësor jopublik, paraqesin brenda 2 muajve një kërkesë për vijimin e kësaj marrëdhënieje, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

19. Nëse kërkesa është e paplotë, veprohet sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

20. Titullari i institucionit shëndetësor publik vlerëson kërkesën e paraqitur, sipas parashikimeve të pikës 5 dhe disponon sipas pikës 6 të këtij udhëzimi.

21. Në rast miratimi të kërkesës së paraqitur, titullari i institucionit njofton ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, duke i bashkëlidhur kërkesën e mjekut, vendimin e arsyetuar, si dhe të dhënat e tjera të nevojshme për publikim në regjistrin përkatës.

22. Në rast mosshqyrtimi të kërkesës së paraqitur ose mosmiratimit të saj, mjeku ka të drejtë të paraqesë ankim, dhe në këtë rast procedohet sipas parashikimeve të pikave 9–14 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu



Informacioni që plotësohet nga kërkuesi

Data plotësimit

Emri:

Mbiemri:

Specialiteti:

Angazhimi pranë një IAL:

Zgjidh institucionin

NIPT:

A12345678A

Kërko specialitetin

Angazhimi pranë institucionit shëndetësor jo publik :

Specialiteti që kërkesi kërkon të ushtrrojë:

Deklaratë:

Unë, nënshkruesi i këtij formulari, konfirmoj se të dhënat e ofruara janë të sakta dhe të plota.

Nëse ndodhim ndryshime në informacionin e ofruar, do të informoj menjëherë palën përkatëse.

Data: / / Emër, Mbiemër, Nënshkrimi:

Informacioni që plotësohet nga institucioni publik

Tipi institucionit:

Statusi i miqut në institucionin jo publik:

Kohëzgjatja e kësaj marrëdhënieje:

Komente:

Spital

Klinikë

Aksioner

Ortak

I punësuar

Administrator

Tregëtar

Dita:

Orët:

Frekuenca:

E hënë

Koha në orë

Javore/Mujore

Vendimi i titullarit të institucionit publik

Miratur

Refuzuar

Arsyet e refuzimit

Data e miratimit/Refuzimit



URDHËR

Nr. 437, datë 12.9.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datën 13.9.2024, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR

Nr. 677, datë 6.9.2024

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP
PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË
PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS
NDËRMJET MINISTRISË SË
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DHE SUBJEKTIT FITUES TË
PROCEDURËS SË KONKURRIMIT
PUBLIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 16, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kontratës tip që lidhet ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe subjektit fitues të procedurës së konkurrimit publik:

a) për ushtrimin e së drejtës së peshkimit në ujërat e brendshme dhe format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri; dhe

b) për zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategji dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

3. Urdhri nr. 44, datë 26.1.2021, “Për miratimin e kontratës tip për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe subjektit fitues të procedurës së konkurrimit publik”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

SHTOJCA 1
KONTRATË TIP

**PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË
UJËRAT E BRENDSHME DHE FORMAT E
TJERA TË PESHKIMIT NË DET PA
PËRDORIMIN E MJETEVE LUNDRUESE**

Kjo kontratë lidhet sot, më datë _____, midis palëve si më poshtë:

Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në vijim “**MBZHR**”, me seli: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë, dhe

Personit fizik/juridik, _____, me administrator _____, me numër NIPT-i: _____, me adresë: _____, mbajtës i kartës së identitetit (ID), me nr. _____, në vijim “**Subjekti**”.

Baza ligjore: kjo kontratë lidhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative,



Kodit Civil dhe legjislacionin në fuqi të peshkimit në momentin e nënshkrimit të saj.

Palët kontraktuese ranë dakord të nënshkruajnë kontratën me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

1. Kjo kontratë ka për qëllim _____
(*ushtrimin e së drejtës për peshkim në ujërat e brendshme/ushtrimin e së drejtës për peshkim në det pa përdorimin e mjeteve lundruese*) nga ana e subjektit _____, në objektin ujqor/: _____ me sipërfaqe _____, në territorin e qarkut të _____, Bashkia _____, Njësia Administrative _____, fshati _____; ose zonën detare me sipërfaqe _____ dhe koordinata _____.

2. MBZHR-ja i njeh të drejtën _____
(*të vendoset forma e aktivitetit*), subjektit _____, brenda të gjithë kuadrit ligjor që rregullon këtë aktivitet, në zonën e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 2

Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese

1. MBZHR-ja nëpërmjet strukturave të saj, merr masa brenda kompetencave ligjore, për të siguruar respektimin e të drejtës së ushtrimit të aktivitetit, që i është dhënë subjektit, nëpërmjet kësaj kontrate.

2. MBZHR-ja gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e subjektit, për:

a) fillimin e investimeve brenda afatit ligjor prej 6 muajsh;

b) realizimin e investimeve në vite, sipas treguesve të deklaruar në planbiznesin e paraqitur si kërkuar për ushtrim të aktivitetit të peshkimit, si më poshtë;

i. _____;

ii. _____ etj.

c) aktverifikimin e investimeve të dokumentuara dhe të plotësuar nga ana e subjektit;

ç) realizimin e prodhimit/zëniet prej _____;

d) depozitimin e deklarimeve statistikore pranë MBZHR-së dhe DSHPA-së deri më 31 mars të vitit në vazhdim;

dh) realizimin e punësimit minimal të synuar prej _____ punonjës.

3. Subjekti zbaton detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fushën e peshkimit dhe:

a) nuk ka të drejtë të nënkontraktojë me subjekte të tjera objektin e kësaj kontrate;

b) detyrohet të lejojë dhe të shoqërojë organin kompetent të ngarkuar për inspektim dhe vëzhguesit/ monitoruesit e MBZHR-së të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara nga kjo kontratë;

c) detyrohet të zbatojë çdo dispozitë të re ligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e peshkimit;

ç) të kryejë pagesën për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit sipas parashikimeve të nenit 3 të kësaj kontrate.

Neni 3

Pagesa

1. Subjekti kryen pagesën për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit, në vlerën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare, për llogari të Drejtorisë Tatimore, Tiranë (numri i llogarisë pranë inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit të qarkut _____, Bashkia _____).

2. Pagesa e parë kryhet menjëherë, në momentin e nënshkrimit të kontratës sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për taksat kombëtare.

3. Pagesat në vitet e tjera kryhen brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim.

Neni 4

Mosrespektimi i kushteve të kontratës

1. Mosrespektimi i kushteve të kësaj kontrate duhet të konstatohet me një akt të veçantë (procesverbal), të mbajtur midis palëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse, i cili nënshkruhet në prani të tyre.

2. Për çdo konstatim të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate, zbatohen dispozitat ligjore në fushën e peshkimit me masën e gjobës ose me zgjidhjen e kontratës.



Neni 5

Pezullimi i kontratës si rezultat i forcës madhore

1. “Forcë madhore”, do të quhet çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është tej parashikimit dhe kontrollit të drejtpërdrejtë apo tërthorë të palës së cenuar duke i shkaktuar pamundësi të plotë apo të pjesshme palës së cenuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate.

2. Rastet e forcës madhore përfshijnë:

a) veprimet e luftës, pushtim, terrorizmin, kryengritjet, grevat në vendin e punës, grevat e përgjithshme apo lokale;

b) rrufetë, zjarret, tërmetet, fatkeqësitë e tjera natyrore;

c) çdo ngjarje ose rrethanë tjetër, që cenon përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate, jashtë vullnetit të palëve.

3. Pala e cenuar përjashtohet nga përmbushja e detyrimit për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia objektive për të përmbushur detyrimet.

4. Palët nuk humbasin të drejtën e zbatimit të kësaj kontrate. Për këto arsye, detyrimisht përpilohet aneks-kontrata shtesë në të cilën do të përcaktohen edhe afatet e reja kohore të zbatimit të kontratës.

5. Dokumentimi i rastit të forcës madhore pasqyrohet në procesverbal të miratuar për çdo rast dhe në prezencë të organit të ngarkuar nga ligji për inspektimin.

Neni 6

Komunikimi

1. Çdo komunikim midis palëve për problemet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate do të bëhet me shkrim në këto adresa:

a) Subjekti: _____.

Adresa e-mail/tel/fax: _____.

Administratori ose përfaqësuesi: _____.

b) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Adresa: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë

Tel/fax: 35522667545

Web: www.bujqesia.gov.al

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 7

Modifikimi i kontratës

Modifikimi i kontratës bëhet me pëlqimin e të dyja palëve dhe përpilimit të aneks-kontratës përkatëse shtesë.

Neni 8

Kohëzgjatja e kontratës

1. Kjo kontratë lidhet për një periudhë _____ dhe sjell efekte nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

2. Me përfundimin e këtij afati, kontrata konsiderohet e zgjidhur.

Neni 9

Rastet e përfundimit të kontratës

Kontrata për ushtrim të aktivitetit të peshkimit përfundon pa vullnetin e palëve dhe pa asnjë detyrim për palët kontraktuese:

a) kur nga struktura të tjera shtetërore merren vendime me rëndësi strategjike, të cilat bien ndesh me aktivitetin në sipërfaqet objekt kontrate;

b) me pushimin së ekzistuari/mbarimin e personit fizik/juridik të cilit i është dhënë e drejta e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit, në objektin ujor përkatës.

Neni 10

Zgjidhja e kontratës

1. MBZHR-ja ka të drejtë zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kontratës kur subjekti nuk ka shlyer vlerën e taksës së zhvillimit të aktivitetit të përcaktuar në nenin 3, të kësaj kontrate, brenda afateve të përcaktuara.

2. Subjektit i hiqet e drejta e ushtrimit të aktivitetit, kur:

a) nuk e ka ushtruar të drejtën e peshkimit, pa shkaqe të arsyeshme, për një periudhë kohore mbi 6 muaj;

b) ka cenuar rëndë mjedisin;

c) nuk ka respektuar zonën e caktuar për zhvillimin e aktivitetit të përcaktuar në këtë kontratë;

ç) nuk realizon sipas afateve të parashikuara në planbiznes vlerën e investimit ndër vite;

d) nëse pas nënshkrimit të kontratës, vërtetohet me fakte, se e drejta e zhvillimit të aktivitetit është



dhënë në bazë të të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta;

dh) me vullnet të lirë kërkon prishjen e kontratës.

Neni 11 Mosmarrëveshjet

1. Çdo mosmarrëveshje e lindur në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate, zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, pa cenuar vlerat, afatet, kushtet teknike, sanksionet dhe gjrobat.

2. Në të kundërt, palët mund t'i drejtohen Gjykatës Administrative kompetente në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Kjo kontratë hartohet dhe nënshkruhet nga palët pjesëmarrëse në 4 (katër) kopje të barasvlershme.

MBZHR

Personi fizik/juridik

SHTOJCA 2 KONTRATË TIP

PËR TË DREJTËN PËR ZHVILLIMIN E AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE PUBLIKE TOKËSORE DHE UJORE

Kjo kontratë lidhet sot, më datë _____, midis palëve si më poshtë:

Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në vijim “MBZHR”, me seli: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë,

dhe

Personit fizik/juridik, _____ me administrator _____, me numër NIPT-i: _____, me adresë: _____, mbajtës i kartës së identitetit (ID), me nr. _____, në vijim “Subjekti”.

Baza ligjore: kjo kontratë lidhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave

Administrative, Kodit Civil dhe legjislacionin në fuqi të akuakulturës në momentin e nënshkrimit të saj.

Palët kontraktuese ranë dakord të nënshkruajnë kontratën me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i kontratës

1. Kjo kontratë ka për qëllim _____ (ushtrimin e së drejtës për zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore/ujore) nga ana e personit fizik/juridik _____, në sipërfaqen tokësore/ujore me koordinata: _____ me sipërfaqe _____.

2. **MBZHR-ja** i njej të drejtën _____ (të vendoset forma e aktivitetit), personit fizik/ juridik _____, me administrator _____, brenda të gjithë kuadrit ligjor që rregullon këtë aktivitet, në zonën e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 2 Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet strukturave të saj, merr masa brenda kompetencave ligjore, për të siguruar respektimin e të drejtës së ushtrimit të aktivitetit, që i është dhënë subjektit të mësipërm, nëpërmjet kësaj kontrate.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e subjektit, për:

a) fillimin e investimeve brenda afatit ligjor prej 6 muajsh;

b) realizimin e investimeve në vite, sipas treguesve të deklaruar në planbiznesin e paraqitur si kërkesë për ushtrim të aktivitetit të akuakulturës, si më poshtë:

i. _____;

ii. _____ etj.

c) aktverifikimin e investimeve të dokumentuara dhe të plotësuar nga ana e subjektit;

ç) realizimin e prodhimit prej _____;

d) depozitimin e deklarimeve statistikore pranë MBZHR-së dhe DSHPA-së deri më 31 mars të vitit në vazhdim;

dh) realizimin e punësimit minimal të synuar prej _____ punonjës.



3. Subjekti zbaton detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fushën e akuakulturës si më poshtë:

a) nuk ka të drejtë të nënkontrakttojë me subjekte të tjera;

b) detyrohet të lejojë dhe të shoqërojë organin kompetent të ngarkuar për inspektim dhe vëzhguesit/monitoruesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara nga kjo kontratë;

c) subjekti detyrohet të zbatojë çdo dispozitë të re ligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e akuakulturës;

ç) të kryejë pagesën për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës sipas parashikimeve të nenit 3 të kësaj kontrate.

4. Subjekti gëzon të drejtën e transferimit të kontratës për ushtrimin aktivitetit të akuakulturës, sipas përcaktimeve të nenit 26, të ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, i ndryshuar.

Neni 3

Pagesa

1. Subjekti kryen pagesën për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës, në vlerën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare, për llogari të Drejtorisë Tatimore, Tiranë (numri i llogarisë pranë inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit të qarkut _____, Bashkia _____).

2. Pagesa e parë kryhet menjëherë, në momentin e nënshkrimit të kontratës sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për taksat kombëtare.

3. Pagesat në vitet e tjera kryhen brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim.

Neni 4

Mosrespektimi i kushteve të kontratës

1. Mosrespektimi i kushteve të kësaj kontrate duhet të konstatohet me një akt të veçantë (procesverbal), të mbajtur midis palëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse, i cili nënshkruhet në prani të tyre.

2. Për çdo konstatim të shkeljeve të dispozitave të kësaj kontrate, zbatohen dispozitat ligjore në fushën e akuakulturës me masën e gjobës dhe me heqjen e së drejtës ose prishjen e kontratës.

Neni 5

Pezullimi i kontratës si rezultat i forcës madhore

1. “Forcë madhore”, do të quhet çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është tej parashikimit dhe kontrollit të drejtpërdrejtë apo tërthortë të palës së cenuar duke i shkaktuar pamundësi të plotë apo të pjesshme palës së cenuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate.

2. Rastet e forcës madhore përfshijnë:

a) veprimet e luftës, pushtim, terrorizmin, kryengritjet, grevat në vendin e punës, grevat e përgjithshme apo lokale;

b) rrufetë, zjarret, tërmetet, fatkeqësitë e tjera natyrore;

c) çdo ngjarje ose rrethanë tjetër, që cenon përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate, jashtë vullnetit të subjektit.

3. Pala e cenuar përjashtohet nga përmbushja e detyrimit për aq kohë dhe në atë masë sa zgjat pamundësia objektive për të përmbushur detyrimet.

4. Palët nuk humbasin të drejtën e zbatimit të kësaj kontrate. Për këto arsye, detyrimisht përpilohet aneks-kontrata shtesë në të cilën do të përcaktohen edhe afatet e reja kohore të zbatimit të kontratës.

5. Dokumentimi i rastit të forcës madhore pasqyrohet në procesverbal të miratuar për çdo rast dhe në prezencë të organit të ngarkuar nga ligji për inspektimin.

Neni 6

Komunikimi

1. Çdo komunikim midis palëve për problemet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate do të bëhet me shkrim në këto adresa:

a) Subjekti: _____.

Adresa: _____.

Adresa e-mail/tel/fax: _____.

Administratori ose përfaqësuesi: _____.

b) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

Adresa: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, Tiranë

Tel/fax: +35522667545

Web: www.bujqesia.gov.al

2. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.



Neni 7

Ndryshimi i kontratës

Ndryshimi i kontratës bëhet me pëlqimin e të dy palëve ose me kërkesën e institucioneve përkatëse në rastet kur janë verifikuar implikime të rënda në mjedis apo në rastet e shfaqjes së sëmundjeve që rezultojnë nga përdorimi i pajisjeve të përdorura, të përcaktuara në kontratë ose në planbiznes. Ndryshimi i kontratës shoqërohet me përpilimin e aneks-kontratës përkatëse shtesë.

Neni 8

Kohëzgjatja e kontratës

1. Kjo kontratë lidhet për një periudhë _____ dhe sjell efekte nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

2. Me përfundimin e këtij afati, kontrata konsiderohet e zgjidhur.

Neni 9

Rastet e ndërprerjes së kontratës

E drejta për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës ndërpritet:

- a) kur mbaron afati i kontratës dhe nuk është paraqitur kërkesë për rinovim;
- b) me pushimin së ekzistuari të personit juridik;
- c) me kërkesën me shkrim të subjektit, drejtuar ministrisë;
- ç) në qoftë se pas nënshkrimit të kontratës vërtetohet me fakte se ajo është lëshuar mbi bazën e të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta.

Neni 10

Rinovimi i kontratës

Subjekti ka të drejtë të kërkojë rinovimin e kësaj kontrate deri në 3 muaj përpara përfundimit të afatit të kontratës.

Neni 11

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet, në rastet, kur:

- a) për dy vjet rresht subjekti nuk dorëzon të dhënat e përcaktuara në nenin 36, të ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, i ndryshuar;

b) subjekti fizik apo juridik kultivon lloje, sasi peshku dhe organizmash të tjerë që nuk janë të përcaktuar në kontratë;

c) së bashku me dënimin me gjobë, për shkelje, vendosen masa mbrojtëse për ndalimin e kultivimit;

ç) subjekti nuk ka ushtruar aktivitetin pa arsye, për një periudhë më shumë se 12 muaj;

d) subjekti nuk ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në këtë kontratë apo nuk ka respektuar rekomandimet e lëna nga organet përgjegjëse për monitorimin dhe inspektimin e aktivitetit të akuakulturës, sipas periudhës së caktuar;

dh) shkelen kushtet e lejes së mjedisit;

e) subjekti nuk ka raportuar për raste sëmundjeje apo për praninë e organizmave të dëmshëm, apo kur ka dështuar për të marrë masat e nevojshme për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve apo të organizmave të dëmshëm në apo rreth zonës së kultivimit, përfshirë këtu dëmtimin e popullatave të peshqve apo organizmave të tjerë detarë;

ë) subjekti nuk e ushtron aktivitetin e akuakulturës në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, i ndryshuar;

f) nuk ka respektuar zonën e caktuar për zhvillimin e aktivitetit të përcaktuar në këtë kontratë.

2. MBZHR-ja ka të drejtë zgjidhjen në mënyrë të njëanshme të kontratës kur subjekti nuk ka shyer vlerën e taksës së zhvillimit të aktivitetit të përcaktuar në nenin 3, të kësaj kontrate, brenda afateve të përcaktuara.

Neni 12

Mosmarrëveshjet

1. Çdo mosmarrëveshje e lindur në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate, zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve, pa cenuar vlerat, afatet, kushtet teknike, sanksionet dhe gjobat.

2. Në të kundërt palët mund t'i drejtohen Gjykatës Administrative kompetente në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Neni 13

Ankimi

Kundër vendimit për zgjidhjen e kontratës, si dhe ndërprerjes së saj, bëhet ankim administrativ, brenda



5 ditëve nga dita e njoftimit/publikimit të tij, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Kjo kontratë hartohet dhe nënshkruhet nga palët pjesëmarrëse në 4 (katër) kopje të barasvlershme.

MBZHR

Personi fizik/juridik

URDHËR Nr. 693, datë 12.9.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve,

nga shteti i Spanjës, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të



Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitropave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) Certifikata shëndetësore veterinare të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitropat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinare shëndetësore të garantojë origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Urdhri nr. 614, datë 9.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe

Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 694, datë 12.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E
BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Burgas	Sredets*	
Yambol	Straldzha*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha



kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Bullgarisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditë e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

d) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

e) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor, jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjepëve dhe deshëve, certifikata veterinare duhet të vërtetohet se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në Manualin Tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetohet se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Urdhri nr. 89, datë 13.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 695, datë 12.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialin biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Lazio	Roma*	
Lazio	Rieti*	
Liguria	Genova*	
Liguria	Savona*	
Liguria	La Spezia	Varese Ligure*
Piemonte	Alessandria*	
Piemonte	Novara	Treccate*
Piemonte	Novara	Novara*
Piemonte	Novara	Vinzaglio*
Piemonte	Torino*	
Piemonte	Asti*	
Piemonte	Vercelli	Lignana*
Sardegna	Nuoro*	
Sardegna	Sassari*	
Campania	Salerno	Casaleto Spartano*
Campania	Salerno	Casalbuono*
Campania	Salerno	Buonabitacolo*
Calabria	Reggio Di Calabria*	
Lombardia	Pavia*	
Lombardia	Milano	Besate*
Lombardia	Milano	Vernate*
Lombardia	Lodi	Sant' Angelo Lodigiano*
Lombardia	Lodi	Marudo*
Lombardia	Lodi	Borghetto Lodigiano*
Emilia-Romagna	Piacenza*	
Emilia-Romagna	Parma*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialin biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Italisë të cilat nuk

janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse



survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose



c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 664, datë 28.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 696, datë 12.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E UKRAINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Chernivets'ka*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernihiv	Sribnians'kyi*	
Chernihiv	Mens'kyi*	
Chernivtsi	Hlybets'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Cherkasy	Smilians'kyi*	
Cherkasy	Cherkas'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Rokytians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Baryshivs'kyi*	
Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Iahotyns'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kiev	Myronivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novomyrhorods'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Kirovohrad	Znamians'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	



Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolacvs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayiv	Berezhnivats'kyi*	
Mykolayiv	Vradiys'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Poltava	Kobelians'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	
Poltava	Poltavs'kyi*	
Ivano-Frankivs'k	Kolomyis'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Vinnitsya	Iampil's'kyi*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, si dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pafektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri

në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit;



Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 663, datë 28.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.



5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 697, datë 12.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU TË
SHFAQUR NË SHTETIN E ÇEKISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve;

b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve.

Nga shteti i Çekisë, sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Karlovarský	Sokolov*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose



iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antittrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit të Kafshëve Tokësore;

d) Certifikata shëndetësore veterinarë të vërtetojë që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve dhe kamelidëve:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antittrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit të Kafshëve Tokësore.

3. Certifikata veterinarë shëndetësore të garantojë origjinën e tyre, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve të vegjël dhe spermën, dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit të ruminantëve.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 698, datë 12.9.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E FRANCËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të pa trajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të pa trajtuar termikisht.

Nga shteti i Francës, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Bretagne	Morbihan	Vannes*
2.	Bretagne	Ille-et-Vilaine	Saint-Malo*
3.	Bretagne	Finistère	Brest*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.



3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 655, datë 23.8.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

NJOFTIM
Nr. 13517, datë 13.9.2024

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE ME BASHKIMIN
EVROPIAN**

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Drejtësisë, nënshkruar më 13.3.2024, në Tiranë, ka hyrë në fuqi më datë 21.8.2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË EVROPËS
DHE PUNËVE TË JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 26, datë 12.9.2024

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDARYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-
KANALIZIME SHKODËR SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendimi i KKRR-së nr. 539),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 12.9.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATOI SE:

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) me vendimin nr. 56, datë 27.12.2023, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.” ka licencuar shoqërinë Rajonale UK Shkodër për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a., me shkresën nr. 1869 prot., datë 28.6.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime. Më pas me shkresën nr.2064/1. prot, datë 30.7.2024, me lëndë “Plotësim dokumentacioni” ka dorëzuar



plotësimet përkatëse sipas afatit të vendosur nga KKRR-ja.

3. Në zbatim të pikës 1, të nenit 10, të “Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, shoqëria rajonale UK Shkodër sh.a., në aplikimin për ndryshim të nivelit tarifar duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesa zyrtare drejtuar ERRU-së për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjellës-kanalizime dhe ITUN;

b) pasqyrat financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një ekspert kontabël i autorizuar;

c) planin e biznesit 5-vjeçar, i cili do të hartohet në përputhje me formatin e aprovuar në këtë metodologji nga ERRU, që është i detyrueshëm vetëm për grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë 100% të kostove totale;

d) modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifar. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit *excel* të miratuar nga ERRU;

e) organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre;

f) aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredidhënëse, në rast se shoqëria është financuar me hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;

g) mendimin e pushtetit vendor për tarifat e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga prefekti i qarkut për legjitimitetin e tij;

h) vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara;

i) procesverbali i seancave dëgjimore me publikun sipas formatit të përcaktuar nga ERRU;

j) subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullore të tarifave të propozuara;

k) lejet ose autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU-së për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit;

l) raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit të instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për

zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU;

m) relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse, dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës;

n) në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese, si dhe akt marrëveshjet midis palëve shitësblerëse;

o) të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullore sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU-së dhe shoqërisë, dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;

p) deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rajonale UK Shkodër sh.a. është plotësuar sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 10 të metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale UK Shkodër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, dhe kuadrin rregullator në fuqi:

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

2. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për njoftimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR I ERRU-së

Ediola Braha

**VENDIM****Nr. 27, datë 12.9.2024****PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË
SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-
KANALIZIME KORÇË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjiellës-Kanalizime” (vendimi i KKRR-së nr. 539),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

Në mbledhjen e datës 12.9.2024, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

KONSTATOI SE:

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), me vendimin nr. 578, datë 2.12.2022, “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a.” ka licencuar shoqërinë rajonale UK Korçë për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Korçë sh.a., me shkresën nr. 653 prot., datë 27.6.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet Ujësjiellës-Kanalizime. Më pas, me shkresën nr. 653/2 prot., datë 8.8.2024, me lëndë

“Plotësim dokumentacioni” ka dorëzuar plotësimet përkatëse sipas afatit të vendosur nga KKRR-ja.

3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 10 të Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjiellës-Kanalizime, shoqëria rajonale UK Korçë sh.a. në aplikimin për ndryshim të nivelit tarifor duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesa zyrtare drejtuar ERRU-së për ndryshimin e tarifave për shërbimet ujësjiellës, kanalizime dhe ITUN-së;

b) pasqyrat financiare të vitit paraardhës certifikuar nga një ekspert kontabël i autorizuar;

c) Planin e biznesit 5-vjeçar, i cili do të hartohet në përputhje me formatin e aprovuar në këtë metodologji nga ERRU-ja, që është i detyrueshëm vetëm për grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë 100% të kostove totale;

d) modeli i aplikimit për nivelin e ri tarifor. Të gjitha tabelat e modelit paraqiten të printuara dhe të firmosura nga shoqëria dhe sipas formatit *Excel* të miratuar nga ERRU-ja;

e) organigramë dhe përshkrimet e punës së stafit sipas pozicionit të tyre;

f) aktmarrëveshjet e kredisë midis shoqërisë dhe institucioneve kredi dhënëse, në rast se shoqëria është financuar me hua dhe skema e planit mujor të shlyerjeve gjatë viteve të kaluara dhe viteve të ardhshme;

g) mendimin e pushtetit vendor për tarifat e propozuara të shprehura në vendimin përkatës dhe konfirmuar nga prefekti i qarkut për legjitimitetin e tij;

h) vendimi i Këshillit të Administrimit për miratimin e tarifave të propozuara;

i) procesverbali i Seancave Dëgjimore me Publikun sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;

j) subvencionet e përfituara nga operatori dhe ato të nevojshme gjatë periudhës rregullore të tarifave të propozuara;

k) lejet ose autorizimet për përdorimin e ujit për shoqëritë UK lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor të shoqëruara me Marrëveshjen ndërmjet shoqërisë UK dhe KBU-së për pagesën e tarifave për përdorimin e ujit;

l) raport i detajuar për gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, në të cilën të përshkruhet inventari i aseteve në përdorim të shoqërisë me të dhëna teknike (përmasat, lloji i materialit, vitit të



instalimit/ndërtimit), përfshirë dhe prioritetet për zëvendësimin e tyre. Ky material do të hartohet sipas formatit të përcaktuar nga ERRU-ja;

m) relacion analitik ekonomik për vitin paraardhës, si dhe për periudhën rregullatore që kërkohet ndryshimi i tarifave, në të cilën shprehet qartë justifikimi dhe argumentet përkatëse dhe objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve të punës;

n) në rast se shoqëria aplikon për tarifë shitje uji me shumicë, në kërkesën e saj për tarifa duhet të paraqesë: relacion teknik dhe ekonomik me llogaritjet e tarifës së shitjes së ujit me shumicë, miratimin e tarifës së kërkuar nga organet drejtuese si dhe akt marrëveshjet midis palëve shitës-blerës;

o) të ketë shlyer detyrimet për pagesën rregullatore sipas kontratës së nënshkruar midis ERRU-së dhe shoqërisë dhe në rast të detyrimeve të prapambetura të ketë shlyer sipas marrëveshjes së nënshkruar mes tyre për shlyerjen me këste të tyre;

p) deklarata për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave sipas nenit 26 dhe nenit 46 të kësaj metodologjie.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rajonale UK Korçë sh.a. është plotësuar sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 10 të Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë rajonale UK Korçë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin e KKRR-së nr. 539 datë 30.12.2021 dhe kuadrin rregullator në fuqi:

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. për miratimin e ndryshimit të nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

2. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike për njoftimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR I ERRU-së
Ediola Braha

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 598 (3265), datë 9.7.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Asim Malaj, i lindur më 6.5.1964, në Tropojë dhe banues në Bushat, Bashkia Vau i Dejës, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të Shtëpisë Rregullatore të Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 572 (3121), datë 2.7.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Sokol Rifat Gradeci, i lindur më 18.3.1970, në Shkodër dhe banues në rr. “Bujar Bishanaku”, shtëpi private te rruga e gjerë Kiras, Shkodër dhe caktimin si kujdestar të tij shtetasin Arben Gradeci.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 176 lekë